



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCES

AGJENCIA PUBLIKE E AKREDITIMIT TE ARSIMIT TE LARTE

Bulevardi “Zhan D’Ark”, Pallatet e Lanës”, Nr. 2, Shk 2, Ap. 17, Tiranë

Tel&Fax: 04 225 7954/226 6302/222 5322

E-mail: aaal@albmail.com

website: ww.aaal.edu.al



RAPORT

PER VEPRIMTARINE E

**AGJENCISE PUBLIKE TE AKREDITIMIT
TE ARSIMIT TE LARTE**

PER PERIUDHEN 3 VJEÇARE

GUSHT 2005-GUSHT 2008

Tiranë, më 28 Gusht 2008

TË PËRGJITHSHME

Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë në veprimtarinë e saj të përgjithshme mbështetet në aktet kryesore ligjore në fushën e Arsimit të Lartë dhe akte të tjera nënligjore si dhe rregullore e procedura të funksionimit të brendshëm e në marrëdhënie me të tjerë, dhe në veçanti, në Planet e Veprimtarive të parashikuara për çdo vit të kësaj periudhe.

Drejtimet kryesore të punës së APAAL gjatë periudhës 3 vjeçare 28 Gusht 2005 - 28 Gusht 2008 kanë mbuluar fushat kryesore të mëposhtme:

1. Vlerësime Instucionale dhe të Programeve të Studimit në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë
2. Vlerësime të Institucioneve dhe Programeve të Studimit në Institucionet Private të Arsimit të Lartë
3. Vlerësime analitike-krahasuese dhe të sistemit të Arsimit të Lartë
4. Rishikim dhe përmirësim të bazës ligjore dhe nënligjore të sigurimit të cilësisë, përfshirë kontributin për hartimin e ligjit të ri të arsimit të lartë
5. Aktivitete botuese dhe informuese, përfshirë krijimin dhe përditësimin e faqes zyrtare të APAAL
6. Fuqizimin e bashkëpunimit me aktorë të ndryshëm të arsimit të lartë
7. Forcimin e bashkëpunimit me organizma ndërkombëtare në fushën e Sigurimit të Cilësisë
8. Krijimin dhe mbajtjen e një baze të plotë të dhënash për Sistemin, Institucionet dhe Programet e Studimit të Arsimit të Lartë në shërbim të politikës së AL, të procesit të vlerësimit dhe akreditimit dhe për informim e transparencë ndaj publikut.
9. Rritjen e kapaciteteve të stafit dhe të eficiencës dhe efektivitetit në përdorimin e burimeve njerëzore e financiare
10. Mbështetjen infrastrukurore, shkresore dhe logjistike të aktivitetit të Këshillit të Akreditimit

BAZA LIGJORE DHE NËNLIGJORE PËR SIGURIMIN E CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË:

a) Baza ligjore dhe nënligjore aktuale që rregullon veprimtaritë kryesore të Sistemit të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë dhe trajtimin e punonjësve e bashkëpunorëve të këtij sistemi:

- Ligji Nr.9741, datë 21.5.2007: “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”
- VKM Nr.303 Datë datë 1.7.1999: “Për krijimin e sistemit të akreditimit në arsimin e lartë” i ndryshuar me VKM Nr.611 datë 04.12.2002 “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.303 datë 01.07.1999 ‘Për krijimin e sistemit të Akreditimit në Arsimin e Lartë’
- Urdhër Nr. 65, datë 23.5.2008 i Kryeministrit “Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Agjencisë së Akreditimit të Arsimit të Lartë”

- Udhëzim i MASH Nr.4 datë 28.02.2006: “Për caktimin e tarifave të vlerësimit dhe akreditimit për shkollat e larta jopublike”
- Udhëzim Nr.30, datë 26.9.2007: “Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit që duhet të paraqesë subjekti juridik, për hapjen e një institucioni privat të arsimit të lartë ose programeve të studimit, në ciklin e parë dhe ciklin e dytë të studimeve”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 29, datë 28.07.2008 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzim Nr.30, datë 26.9.2007: “Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit që duhet të paraqesë subjekti juridik, për hapjen e një institucioni privat të arsimit të lartë ose programeve të studimit, në ciklin e parë dhe ciklin e dytë të studimeve”
- Udhëzim i MASH Nr.14 datë 03.04.2008 “Për Hapjen dhe Organizimin e Programeve të Studimit të Ciklit të Dytë në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë”
- Udhëzim i MASH Nr.15 datë 04.04.2008 “Për Organizimin e Studimeve në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë”
- Udhëzim i MASH Nr.20 datë 09.05.2008 “Për veprimtarinë e personelit akademik në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë”
- Udhëzim i MASH Nr.30 datë 29.07.2008 “Për Organizimin e Studimeve të Larta Universitare për Formimin Profesional të Mësuesve”
- Ligj Nr.7961 datë 12.07.1995: “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar
- VKM Nr. datë 2008: “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve të disa institucioneve, në varësi të ministrave të linjës”
- Udhëzimin Nr.12 Datë 15.11.2006: “Mbi punonjësit që paguhen jashtë numrit të punonjësve buxhetorë të miratuar për ministrinë dhe institucionet buxhetore”, i ndryshuar
- VKM Nr. 720 datë 29. 11. 1995: “Për shpërblimin e punonjësve buxhetorë që aktivizohen në veprimtari të tjera dytësore shtetërore”
- VKM Nr.120 datë 27.01.1997: “Për shpërblimin e autorëve të veprave shkencore, teksteve shkollore dhe materialeve të tjera të dokumentacionit shkollor”

b) Akte të brendshme dhe të tjera të APAAL:

- Udhëzues për Vlerësimin e Brendshëm të Cilësisë në Arsimin e Lartë, i rishikuar; Qershor 2006
- Udhëzues për Vlerësimin e Jashtëm të Cilësisë në Arsimin e Lartë, i rishikuar; Dhjetor 2006
- Aspekte dhe tregues të Cilësisë në Arsimin e Lartë Procedura për vlerësimin dhe akreditimin e institucioneve dhe programeve në Arsimin e Lartë, i rishikuar; Dhjetor 2006
- Procedura për Vlerësimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë; Dhjetor 2006
- Statuti i Këshillit të Akreditimit; Qershor 2004
- Rregullore e Brendshme e Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë; Nëntor 2005
- Përshkrimet për funksionet, përgjegjësitë dhe detyrat e punonjësve të APAAL; Tetor 2006

- Standardet dhe Udhëzimet Europiane për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Europiane të Arsimit të Lartë; dokumentat I ENQA-s, I përkthyer dhe I përshtatur nga APAAL; Shtator 2006
- Udhëzime për Arsimin e Lartë Ndërkufitar; dokument i UNESCO-OECD; I përkthyer dhe I përshtatur nga APAAL; Shkurt 2007
- Kriteret dhe Procedura për vlerësimin e Programeve të Reja të Studimit të Ciklit të Parë, në IAL Publike dhe Private; Mars 2008
- Kriteret dhe Procedura për vlerësimin e Programeve të Reja të Studimit të Ciklit të Dytë (DND), në IAL Publike dhe Private; Prill 2008
- Kriteret dhe Procedura për vlerësimin e Programeve të Reja të Studimit të Ciklit të Dytë (MNP), në IAL Publike dhe Private; Mars 2008
- Kriteret dhe Procedura për vlerësimin e Programeve të Reja të Studimit të Ciklit të Tretë (MND), në IAL Publike dhe Private; Maj 2008

PJESA PËRSHKIMORE

Mbështetur në Planin e Veprimtarive për çdo vit si dhe në varësi nga kërkesat e MASH dhe Institucioneve të Arsimit të Lartë për vlerësime, APAAL ka kryer një numër të madh vlerësimesh gjatë harkut kohor 3-vjecar 28 Gusht 2005 - 28 Gusht 2008, sipas viteve si më poshtë:

- 29 vlerësime institucionale; nga këto 22 në IAL Publike dhe 7 në IAL Private; këtu përfshihen si ato të kryera para procesit të hapjes/licensimit, ashtu dhe ato në kuadrin e procesit të akreditimit apo të ristrukturimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë në përputhje me legjislacionin e ri
- 456 vlerësime në nivel të programeve të studimit; nga këto 303 në IAL Publike dhe 153 në IAL Private; këtu përfshihen si ato të kryera para procesit të hapjes/licensimit, ashtu dhe ato në kuadrin e procesit të akreditimit;
- Vlerësime analitike të degëve të veçantatë studimeve në shkallë vendi
- Vlerësime të sistemit dhe krahasuese institucionale/programesh për IAL Publike dhe Private

Të dhënat e plota për këto vlerësime, llojin, numrin e përgjithshëm të vlerësimeve për secilin model diplome të lëshuar nga IAL publike dhe private dhe shpërndarjen e tyre sipas viteve, jepen në tabelën 1, për IAL Publike dhe në tabelën 2, për IAL Private.

Vlerësime në Institucionet e Arsimit të Lartë Publik

Institucioni i Arsimit të Lartë (IAL) Publik	VITI 2005		VITI 2006		VITI 2007							VITI 2008						
	Vlerësim institucional	Diploma të vlerësuara	Vlerësim institucional	Diploma të vlerësuara	Vlerësim institucional	Diploma të vlerësuara (DNP)	DND	DIND	MNP	MND	DR / SPA	Vlerësim institucional	DNP	DND	DIND	MNP	MND	DR / SPA
Universiteti i Tiranës	0	0	2	5	1	2	0	0	7	0	2	2	0	34	3	20	18	5
Universiteti Politeknik i Tiranës	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	26	0	0	0	0
Universiteti Bujqësor i Tiranës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	4	15	0	0	0	0
Universiteti A.XH, Elbasan	0	2	1	4	2	0	0	0	10	1	0	0	0	6	0	23	0	0
Universiteti I.Q Vlorë	0	2	1	2	2	3	0	0		0	0	0	9	0	3	8		2
Universiteti F.S.N, Korçë		2		1	2	7	0	0	2	0	0	0	6	1	0	1		0

Universiteti E.Ç, Gjirokastrë		2	1	3	1	5	0	0	1	0	0	0	0	0	0	13	1	0
Universiteti L.G, Shkodër	0	2	1	3	3	7	0	0	1	0	0	0	0	7	0	4	0	0
Universiteti A.M, Durrës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0		3	0	0	0	0	0
Akademia e Arteve	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Akademia e Sporteve V.K	0	0	0	0	1	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Akademia e Policisë A.Z	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
TOTALI	0	11	6	18	13	25	0	0	21	1	2	3	22	89	6	69	19	7

Tabela 1. Numri i vlerësimeve të kryera nga Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, gjatë periudhës Gusht 2005 – Gusht 2008 në IAL Publike

Vlerësime në Institucionet e Arsimit të Lartë Privat



Institucioni i Arsimit Lartë (IAL) Privat	VITI 2005		VITI 2006		VITI 2007				VITI 2008				IAL private të akredituara deri në 28.08.2008		
	Vlerësim institucional	Diploma të vlerësuara	Vlerësim institucional	Diploma të vlerësuara	Vlerësim institucional	Diploma të vlerësuara (DNP)	DND	DIND	MNP	Vlerësim institucional	DNP	DND		DIND	MNP
Universiti "N.Y, Tiranë"	0	0	0	0	0	0	0	0	2	0	0	0	0	0	Po
Universiteti "Zoja e Këshillit të Mirë"	0	0	1	7	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	Po
Universiteti "Europian i Tiranës"	0	0	0	0	0	4	0	0	0	0	0	0	0	0	Jo
"Aldent"	0	0	0	0	0		1	0	0	0	0	0	0	0	Jo
Universiti "Epoka"	0	0	0	0	0	7	0	0	0	0	0	0	0	0	Jo
"S&P Qiriazi"	0	0	0	0	0	6	0	0	0	1	0	0	0	0	Jo
"WISDOM University"	0	0	0	0	0	2	0	0	0	0	0	0	0	0	Jo
Luigj Benussi	0	0	0	0	0	2	0	0	0	0	0	0	0	0	Jo
ISSAT (Inst. i Studimeve strategjike)	0	0	0	0	0	0	0	0	6	0	0	0	0	0	Jo
Univ. Amerikan i Tiranës (Medikom)	0	0	0	0	0	14	8	0	0	0	12	6	2	0	Jo
Univ. "MESDHETAR" i Tiranës.	0	0	0	0	0	3	0	0	0	0	3	0	0	0	Jo

Shkolla e Lartë Jopublike "ILLYRIA"	0	0	0	0	0	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	Jo
Universiteti "DEMOKRACIA"	0	0	0	0	0	6	0	0	0	0	7	0	0	0	0	Jo
Klinika e syve "UZLLOVA"	0	0	0	0	0		0	0	2	0	0	0	0	0	0	Jo
Kolegji Prof. "Ivoclar Vivadent & Partners"	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0	1	0	0	0	0	Jo
Universiteti "Kristal"	0	0	0	0	0	2	0	0	1	1	0	0	0	0	0	Në proces
Universiteti "UFO"	0	0	0	0		0	0	0	0	1	0	0	0	0	0	Në proces
Shkolla e Lartë Universitare Jopublike "Marubi"	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	Po
Shkolla e Lartë Universitare Private "Luarasi"	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	Po
Shkolla e Lartë Universitare Private "Marin Barleti"	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	Jo
Shkolla e lartë Universitare Private "Justiniani I"	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	Jo
Shkolla e Lartë Universitare Private "Justicia"	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	Jo
Shkolla e Lartë Universitare Private "Medikadent"	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	Jo
IAL "Nëna Mbretëreshë Geraldinë"			0	0	0	5	0	0	0	0	0	0	0	0	0	Jo

Shkolla e Lartë Universitare Private "Polis"	0	0	0	00	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	Jo
"Vlora University"	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	11	0	1	0	0	Jo
Universiteti "UEPT"			0	0	0	0	0	0	0	0	7	3	0	3	0	Jo
Universiteti "Faik Konica"	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	Jo
Universiteti "Nehemia"	0	0			0	0	0	0	0	1	11	2	0	0	0	Jo
"Shkolla e Lartë Britanike"					0	0	0	0	0	0	3	0	0	0	0	Jo
IAL "Eralba"	0	0			0	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0	Jo
TOTALI	0	0	1	7	2	54	9	0	11	5	55	11	3	3	-	



Tabela 2. Numri i vlerësimeve të kryera nga Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, gjatë periudhës Gusht 2005 – Gusht 2008 në IAL Private.

Duke shfrytëzuar bazën e të dhënave të Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë nga viti 2001 deri në Gusht 2008, është paraqitur grafikisht ecuria e vlerësimeve institucionale dhe e programeve për IAL publike, dhe nga 2005 – 2008 për IAL private.



Për herë të parë, nisur nga Tetori i vitit 2007, si detyrim që rrjedh nga Ligji i ri i Arsimit të Lartë, APAAL ka filluar dhe vazhdon procesin e vlerësimit për një numër të madh kërkesash/aplikimesh të IAL-ve Publike për hapjen e kurseve të studimit në përputhje me procesin e Bolonjës për dy nivelet kryesore: Ciklin e Parë dhe Ciklin e Dytë të Studimeve (shih më poshtë). Në tabelën 3, jepet veprimtaria e APAAL për vlerësimet e programeve dhe strukturave duke marrë së bashku IAL Publike dhe ato Private.

Viti	Vlerësime institucionale të strukturave	Programet e reja të studimit të vlerësuara	Vlerësime për hapje filialesh
Viti 2005	6	11	0
Viti 2006	7	33	0
Viti 2007	6	112	2
Viti 2008	0	212	3




1.1. Vlerësime në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë


Mbështetur në kërkesat dhe ndryshimet që solli ligji i ri i Arsimit të Lartë, udhëzimet e reja të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës gjatë vitit 2008 (shih më lart bazën ligjore dhe nënligjore), si dhe procedurat e aktet e brendshme të Agjencisë e Këshillit të nxjerra për zbatimin e këtyre udhëzimeve, APAAL ka kryer disa lloje vlerësimesh në Sistemin Publik të Arsimit të Lartë:

- Vlerësime të para për hapjen e programeve të reja të studimeve
- Vlerësime në kuadrin e procesit të akreditimit periodik të IAL dhe programeve
- Vlerësime institucionale të strukturave të IAL
- Vlerësime për hapje filialesh të reja

Në figurën 4, sillen këto të dhëna si total dhe të ndara sipas viteve



Viti	Vlerësime të para për hapje programesh të reja studime	Vlerësime institucionale
Viti 2005	0	0
Viti 2006	0	6
Viti 2007	49	13
Viti 2008	212	3







Të dhëna më të hollësishme mbi programet jepen në tabelën dhe figurat e mëposhtme.

Rezultatet e Vlerësimit të PRS të ardhura në APAAL nga Universitetet Publike për vitin 2005-2008						
Lloji i Diplomës	Vlerësim Pozitiv	Vlerësim Negativ	Vlerësim Pozitiv me Kusht	Vlerësim në Proces		Totali
				Realizuar procesi i parë i vlerësimit	Të ardhura dhe të pavlerësuar	
DNP	11	8	0	0	0	19
DND	34	2	1	30	46	113
DIND	0	23	1	47	24	95
MNP	0	0	0	0	3	3
MND	0	2	0	0	18	20
SPA	1	1	0	0	0	2
DR	0	0	0	2	5	7
TOTAL	46	36	2	175		





1.2. Vlerësime në Institucionet Private të Arsimit të Lartë


Mbështetur në kërkesat dhe ndryshimet që sjell ligji i ri i Arsimit të Lartë dhe Udhëzimit Nr.30, date 26.9.2007 i Ministrisë dhe Arsimit dhe Shkencës, si dhe Procedurës së re të agjencisë për vlerësimin paraprak të programeve në Institucionet Private të Arsimit të Lartë, në periudhën tre vjeçare janë vlerësuar, me kërkesë të MASH, 148 programe të reja studimi të kërkuara nga 31 IAL private egzistuese ose të reja, para licensimit.

Përveç vlerësimeve të mësipërme, janë kryer dhe vlerësimet e para për akreditim të programeve të studimit dhe Institucioneve Private të Arsimit të Lartë. Këto të dhëna paraqiten në tabelëne e mbposhtme në të cilën jepen , përkundrejt listës së plotë të IAL private të licensuara deri më sot¹.



¹ Lista e plotë të IAL private të licensuara jepet në: www.aaal.edu.al



Vitet	IAL Private të Akredituara	IAL private në Proces	Vlerësime të para për hapje programesh të reja studimi	Vlerësime institucionale
Viti 2005	0	-	0	0
Viti 2006	2	-	0	1
Viti 2007	2	-	74	2
Viti 2008	0	2	72	5

Rezultatet e Vlerësimit të PRS të ardhura në APAAL nga Universitetet Private për periudhën Nëntor 2007- Gusht 2008						
Lloji i Diplomës	Vlerësim Pozitiv	Vlerësim Negativ	Vlerësim Pozitiv me kusht	Të kthyera për mungese dokumentacioni	Të ardhura dhe të pavlerësuara	Totali
DNP	67	8	31	6	5	117
DND	6	14	0	0	9	29
DIND	1	0	2	0	1	4
MNP	7	1	6	0	5	19
MND	0	0	0	0	7	7
SPA	0	0	0	0	0	0
DR	0	0	0	0	0	0



Të dhëna më të hollësishme mbi programet jepen në tabelën dhe figurat e mëposhtme





Gjatë periudhës Prill-Korrik 2008, APAAL ka kryer vlerësimin e plotë institucional dhe të tre programeve të studimit në kuadrin e kërkesës së IAL përkatëse për akreditimin e parë të tyre pas licensimit. Këto vlerësime u përkasin dy Institucioneve Private të Arsimit të Lartë: Shkolla e Lartë Universitare “UFO” dhe Shkolla e Lartë Universitare “Kristal”. Këto vlerësime ndodhen në fazën e shqyrtimit përfundimtar nga Këshilli i Akreditimit.

1.3. Shqyrtime të kërkesave për vlerësime të reja për programe të IAL Publike dhe Private

Gjatë muajit Korrik 2008, në APAAL ka ardhur një numër i madh kërkesash për Vlerësime Programesh të Reja nga IAL Publike: gjithsej janë 120 programe të Ciklit të Parë, të Dytë dhe të Tretë, të aplikuar nga Universitetet e Tiranës, Politeknik dhe Bujqësor. Në shqyrtim janë dhe dy

aplikime për hapje filialesh të reja të Universitetit të Tiranës në Sarandë dhe Kukës dhe të Universitetit Bujqësor të Tiranës në Lushnjë. Për IAL Private ka filluar procesi i vlerësimit për disa programe studimi për një Institucion të Ri të Arsimit të Lartë Publik (Eralba) dhe kërkesa nga IAL Private ekzistuese (Shkolla e Lartë Universitare Private “S. dhe P. Qiriazit” për programe të ciklit të dytë dhe nga Shkolla e Lartë Universitare Private “Kristal” për programe të reja studimi dhe një filiali në qytetin e Korçës)

2. Vlerësime analitike dhe të sistemit të arsimit të lartë

Gjatë vitit 2007, APAAL ka kryer katër vlerësime analitike-krahasuese dhe të sistemit të arsimit të lartë:

2.1: Vlerësimin institucional deri në nivel departamenti të të gjitha universiteteve publike në vend

Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, mbështetur në të dhënat zyrtare të grumbulluara gjatë viteve akademike 2005-2006 dhe 2006-2007 dhe pasi i verifikoi ato gjatë muajit tetor-nëntor 2007, hartoi strukturat organizative deri në nivel departamenti për të gjitha IAL egzistuese Publike. Në këtë analizë, për natyrën e tyre dhe standardet specifike që kanë, nuk u përfshinë Akademia e Arteve, Akademia e Sporteve, Akademia e Policisë dhe Universiteti Ushtarak.

Të dhënat e grumbulluara përfshinin: a) IAL me emërtimin përkatës; b) organizimin në fakultete dhe njësi të tjera; c) numrin e fakulteteve dhe/ose njësive të tjera me emërtimin përkatës; d) organizimin e çdo fakulteti në departamente dhe/ose njësi të tjera përbërëse me emërtimin përkatës.

2.2: Vlerësim analitik për stafet akademike të Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë

Në këtë vlerësim u përdorën të dhëna analitike për Stafet akademike në IAL publike, dhe konkretisht të dhëna institucionale si: nr i departamenteve, kualifikimi i stafit akademik të brendshëm, nr i përgjithshëm i stafit ..

2.3: Vlerësim analitik-krahasues për njësitë e arsimit të lartë dhe diplomat në fushën e mësuesisë


Këtu u morrën në studim ato IAL dhe njësi përbërëse të tyre që ofrojnë programe studimi për përgatitjen e mësuesve si dhe diplomat përkatëse. Për këtë u përdorën tregues të tillë si: nr. i stafit të B/J, shkalla e kualifikimit të stafit, raporti Staf i Brendshëm/student dhe raporti Staf i përgjithshëm/student

2.4: Analizë e sistemit të Arsimit të Lartë Privat

Në këtë vlerësim u shqyrtuan në IAL Private operuese disa indikatorë: nr. i IALP të licensuara, licensimi i tyre në vite, sa prej tyre janë të akredituara , sa janë në proces akreditimi;

nr.i studentëve në IALP krahasuar dhe me totalin e studentëve ne IAL, dhe një analizë të fushave në të cilat operojnë dhe ofrojnë programe studimit këto IAL .

Për kryerjen mbi baza profesionale të vlerësimeve, Agjencia angazhon gjerësisht ekspertë të jashtëm vendas dhe të huaj. Në diagramën që vijon paraqitet numri i ekspertëve të jashtëm të angazhuar, të ndarë në vendas dhe të huaj, sipas viteve dhe të krahasuara edhe me vitet përpara periudhës që përfshin raporti.



Dokumentacioni i këtyre vlerësimeve, pasi është shqyrtuar në mbledhjet përkatëse të Këshillit të Akreditimit, është dërguar në MASH pas përfundimit të çdo procesi. Një kopje e tyre ndodhet gjithashtu e ruajtur në arkivën e APAAL.

3. Rishikimi dhe përmirësimi i bazës ligjore dhe nënligjore në fushën e sigurimit të cilësisë

Gjatë vitit 2006 dhe 2007 APAAL ka marrë pjesë aktivisht dhe ka kontribuar për hartimin dhe finalizimin e Ligjit të Ri të Arsimit të Lartë Nr.9741, i 21.5.2007, që hyri në fuqi më 1.07.2007.

Në mbështetje dhe sipas kërkesave të këtij ligji, APAAL në konsultim dhe me eksepr të ligjorë, ka përgatitur draftin e tre akteve nënligjore që lidhen me Sigruimin e Cilësisë: akt-rrregulloren për funksionimin e Agjencisë, aktin për funksionimin e KA, aktin për tarifën dhe pagesat për vlerësimin dhe akreditimin, si dhe strukturën e re të agjencisë. Po në mbështetje dhe zbatim të këtij ligji janë përgatitur, në bashkëpunim edhe me Këshillin e Akreditimit, akte të reja procedurash për vlerësimin dhe akreditimin.

Përveç kontributit që APAAL dhe KA kanë dhënë për hartimin e udhëzimeve të MASH gjatë vitit 2008, APAAL ka përgatitur e dërguar në MASH një sërë aktesh të tjera nënligjore, të listuara më poshtë:

- Projekt-Vendimi i Këshillit të Ministrave për “Institucionet dhe Sistemin e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë”, detyrim që del nga Ligji Nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; dërguar në MASH më 15.7.2008.
- Projekt-Vendimi i Këshillit të Ministrave “Për pagesat e bashkëpunëtorëve të jashtëm vendas dhe të huaj që aktivizohen në veprimtaritë që lidhen me vlerësimin dhe akreditimin në arsimin e lartë”; dërguar në MASH më 16.7.2008.
- Projekt-Vendimi i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifave të vlerësimit dhe akreditimit në Arsimin e Lartë”; dërguar në MASH më 16.7.2008.
- Projekt-Urdhër i Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë”; dalë si Urdhër Nr. 65, datë 23.5.2008 i Kryeministrit “Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Agjencisë së Akreditimit të Arsimit të Lartë”
- Procedurat dhe kriteret për vlerësimin e një kursi të ri studimi të Ciklit të Parë të Studimeve, Diplomë e Nivelit të Parë (DNP) në Arsimin e Lartë; miratuar nga Këshilli i Akreditimit në 14 prill 2008.
- Procedurat dhe kriteret për vlerësimin e një kursi të ri studimi të Ciklit të Dytë të Studimeve, Diplomë e Nivelit të Dytë (DND) në Arsimin e Lartë; miratuar nga Këshilli i Akreditimit më 3 maj 2008.
- Procedurat dhe kriteret për vlerësimin e një kursi të ri studimi të Ciklit të Dytë të Studimeve, Master i Nivelit të Parë (MNP) në Arsimin e Lartë; miratuar nga Këshilli i Akreditimit më 3 maj 2008.
- Procedurat dhe kriteret për vlerësimin e një kursi të ri studimi të Ciklit të Tretë të Studimeve, Master i Nivelit të Dytë (MND) në Arsimin e Lartë; paraqitet për miratim në mbledhjen e Këshillit të Akreditimit më 26.8.2008.
- Procedurat, kriteret dhe termat e referencës për rekrutimin e ekspertëve të huaj që angazhohen në procesin e vlerësimit të jashtëm
- Platforma dhe Termat e Referencës për Vlerësimin e Jashtëm të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe të Sistemit të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë nga një Kompani (Agjenci) e huaj: “Terms of Reference for the External Evaluation of Higher Education Institutions and External Evaluation of Quality Assurance Institutions for Higher Education”; dërguar Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Genc Pollo më 23.7.2008.

Të gjitha aktet nënligjore, të listuara më sipër, (me përjashtim të akteve të brendshme të Agjencisë, që miratohen nga KA), pasi janë shqyrtuar dhe miratuar më parë nga KA në mbledhjet e rradhës, janë dërguar për procedim të mëtejshëm në MASH.

4. Aktivitete botuese dhe informuese të APAAL

Gjatë 2007, agjencia ka përgatitur e shpërndarë si në mënyrë individuale e institucionale, ashtu dhe përmes aktiviteteve që ka organizuar me aktorë të ndryshëm të arsimit të lartë një sërë dokumentash informuese, njohëse e sensibilizuese në fushën e cilësisë si: procedura të reja apo versione të rishikuara në përputhje me ligjin e ri të procedurave ekzistuese, procedura të reja që diktohen nga ligji i ri, dokumenta të rëndësishëm ndërkombëtarë të fushës si dhe udhëzues për aplikimin për vlerësime, si kusht për procedura të rregullta e të

paranjohura. Një pjesë e mirë e këtyre dokumentave janë botuar në formë fletëpalosjesh e broshurash.



- Gjatë 2008 APAAL ka ristrukturuar tërësisht ëeb site e saj. Tashmë në faqen zyrtare të Agjencisë (www.aaal.edu.al) si IAL ashtu dhe publiku i gjerë gjen informacion të përditësuar mbi statusin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në vend, mbi gjendjen e vlerësimit dhe akreditimit të institucioneve publike dhe private të arsimit të lartë dhe programet e studimit që ofrojnë, mbi aktivitetin në vend dhe jashtë vendit të institucioneve të sigurimit të cilësisë, të dhëna të detajuara për IAL dhe raportet vjetore të Agjencisë dhe Këshillit të Akreditimit. I gjithë informacioni është pasuruar, ristrukturuar dhe përshtatur sipas kërkesave të legjislacionit të ri për Arsimin e Lartë dhe në përputhje me standardet europiane për transparencën dhe informimin e publikut për cilësinë e AL.
- Është dërguar për botim Raporti i Veprimtarisë Vjetore të APAAL dhe Këshillit të Akreditimit për vitin 2007 i Agjencisë, i cili ndodhet edhe në faqen zyrtare të APAAL.
- APAAL ka bërë disa takime me disa IAL për ti udhëzuar mbi kriteret dhe procedurat e vlerësimit për programet e reja të studimit të nivelit të parë dhe të dytë, në përputhje me kërkesat e standardet e Ligjit të Arsimit të Lartë dhe udhëzimeve të MASH për këto programe që kanë dalë gjatë vitit 2008. Ky proces do vazhdojë gjatë muajve të fundit të vitit me aktivitete për diplomat e fushës së Mësuësisë, në zbatim të udhëzimit përkatës të MASH dalë në 29 korrik 2008.

5. Fuqizimi i bashkëpunimit me aktorë të ndryshëm të arsimit të lartë përmes organizimit të takimeve e aktiviteteve të tjera të përbashkëta

Janë organizuar disa takime kryesisht me përfaqësues të IAL për çështje që lidhen me Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë Publik dhe Privat si dhe për fusha specifike si ajo e Mësuesisë. Në Pjesën B, pika 6, ndodhen të dhëna e detaje mbi këto aktivitete.

Pjesë e këtyre aktiviteteve kanë qenë dhe takime me IAL Publike dhe Private që lidhen me Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në AL, detyrim që rrjedh nga legjislacioni i ri. Konkretisht APAAL ka përgatitur një Draft-Udhëzim për ngritjen dhe funksionimin e Sistemeve të Brendshme të Cilësisë në Institucionet e Arsimit të Lartë dhe ka organizuar disa takime gjatë vitit 2008 me IAL publike dhe private për diskutimin e këtij udhëzimi përpara miratimit dhe zbatimit të tij në praktikë. Procesi i diskutimit dhe konsultimit do të mbyllet në muajt tetor-nëntor 2008, pas një takimi përfundimtar me të gjitha IAL publike dhe private në vend.

6. Forcimi i bashkëpunimit me organizma ndërkombëtare në fushën e Sigurimit të Cilësisë

Gjatë 2007, APAAL ka shtuar kontaktet dhe ka forcuar lidhjet dhe bashkëpunimin me organizma e rrjete të rëndësishme ndërkombëtare që operojnë në fushën e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë. Përvec të qenit antare me të drejta të plota në dy rrjete të rëndësishme rajonale e ndërkombëtare të Agjencive të Sigurimit të Cilësisë (INQAAHE dhe CEE Network), APAAL ka vendosur tashmë lidhjet të vazhdueshme edhe me Organizatën Europiane më prestigjioze të Sigurimit të Cilësisë (ENQA), me Këshillin e Europës dhe UNESCO; disa herë APAAL ka marrë pjesë në aktivitete të ENQA-s dhe KE me kërkesën e tyre të fundit, edhe si referuese e moderatore e ëorkshopeve apo seancave të vecanta. Aktiviteti më i rëndësishëm i APAAL në rang ndërkombëtar dhe rezultat i këtij bashkëpunimi disavjecar, është pa dyshim organizimi i Asamblesë së Përgjithshme të Rrjetit të Agjencive të Sigurimit të Cilësisë të Europës Qendrore dhe Lindore (CEE-Network) në Shqipëri në 23-25 Maj 2008. Me iniciativën dhe ftesën e saj, APAAL-së ju besua për herë të parë organizimi i këtij evenimenti. Në të morën pjesë Drejtuesit e Agjencive të SC të 25 vendeve të Europës dhe personalitete të larta të fushës së Sigurimit të Cilësisë në Politikën e Bashkimit Europian si Peter Ëilliams, President i organizatës ndërkombëtare ENQA, Christina Rozsnyai, Sekretare e Përgjithshme e Rrjetit Rajonal CEE Network, Aspasija Hadzisce, Drejtore e Agjencisë për Iniciativë në Reformën Arsimore të Europës Juglindore, dhe pjesëmarrës të tjerë. Ky aktivitet konsistoi në a) Bashkëpunimin e Agjencive anëtare të CEEN për njohjen e përbashkët të vendimeve të akreditimit; b) Iniciativën për Reformë në Arsim në vendet e Europës Jug-Lindore në drejtim të bashkëpunimit në Rajon dhe të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë; c) mbajtja dhe forcimi i kontakteve të përhershme dhe shkëmbimi i informacionit në këtë rajon për bashkëpunimin dhe; d) njohjen e procedurave/rezultateve të vlerësimit të cilësisë në fushën e Arsimit të Lartë. **Ky aktivitet u mbështet nga Programi "Cilësi dhe Barazi në Arsim".**

Në këtë takim, Drejtorja e APAAL Dhurata Bozo u zgjodh dhe u ngarkua të përfaqësojë Rrjetin e Europës Qendrore dhe Lindore (CEE Network) në Rrjetin Ndërkombëtar të Agjencive të Sigurimit të Cilësisë, INQAAHE; duke qenë që prej vitit 2007 antare e Bordit të këtij rrjeti ndërkombëtar, si përfaqësuese e agjencive të të gjithë rajonit.

Në kuadrin e ndërkombëtarizimit dhe rritjes së besimit e reputacionit edhe jashtë kufijve kombëtarë, APAAL ka filluar procesin e vetëvlerësimit të punës së saj sipas kërkesave e standardeve Europiane për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë hartuar nga ENQA; ky proces do të vijojë në përputhje me kërkesat e procedurat e Regjistrimit Europian të Agjencive të Cilësisë (EQAR), si detyrim që rrjedh nga procesi i Bolonjës dhe Ligji i ri i Arsimin të Lartë. Prosesi i aplikimit nuk ka filluar pasi, ende nuk janë bërë publike nga EQAR udhëzuesit se si aplikohet për përfshirjen në këtë regjistër; këto pritet të dalin në shtator 2008. APAAL do kërkojë në fund të këtij procesi, vlerësimin e të jashtëm të aktivitetit të saj nga ekspertë të huaj të organizatës europiane të Sigurimit të Cilësisë ENQA dhe të Regjistrimit EQAR.


7. Krijimi, mbajtja dhe përditësimi i një baze të plotë të dhënash për Sistemin, Institucionet dhe Programet e Studimit të Arsimin të Lartë në shërbim të politikës së AL, të procesit të vlerësimit dhe akreditimit dhe për informim e transparencë ndaj publikut.

Duke filluar nga Nëntori i vitit 2007, APAAL ka filluar të krijojë një bazë të dhënash të plota për Sistemin e Arsimin të Lartë, Institucionet Publike dhe Private të Arsimin të Lartë, Programet ekzistuese dhe të reja të studimit si dhe të dhëna që dalin nga procesi i vlerësimit dhe akreditimit të tyre. Këto të dhëna apo fragmente të tyre janë kërkuar e përdorur nga MASH, KA, KALSH dhe Këshilli i Ministrave, në funksion të hartimit të politikave të përgjithshme apo sektoriale të AL, për nxjerrjen e udhëzimeve në frymën e legjislacionit të ri dhe në përshtatje me kërkesat e procesit të Bolonjës si dhe në funksion të ristrukturimit të sistemit apo të institucioneve apo programeve të vecanta. Kjo bazë të dhënash ushqen dhe ndihmon gjithashtu proceset e vlerësimit dhe akreditimit, por nga ana tjetër këto procese e përditësojnë vazhdimisht këtë informacion. Me dizejnimin e ëeb site të ri të APAAL, ky informacion po plotësohet gradualisht dhe përditësohet çdo javë nga APAAL, si detyrim për informim dhe transparencë ndaj publikut.

8. Rritja e eficiencës dhe efektivitetit të përdorimit të burimeve financiare

Mbështetja financiare e APAAL ka ardhur duke u rritur gjatë këtyre viteve. Në Diagramën Më posht. tregohet buxheti gjatë tre viteve. Ndërkohë është rritur dhe aftësia përdoruese e buxhetit nga ana e APAAL. Në figurën e mëposhtme paraqitet aftësia përdoruese e buxhetit krahasuar me atë të planifikuar për çdo vit të kësaj periudhe, krahasuar dhe me vitet e mëparshme. Vërejmë së të dhënat për vitin 2008 përfshijnë shifrat deri në korrik të këtij viti.


Periudha	Buxheti i parashikuar (Plan)	Buxheti i zbatuar (Fakt)
Viti 2005	10,600,000	8,007,075
Viti 2006	18,300,00	12,880,847
Viti 2007	14,520,000	13,443,294
Viti 2008	11,142,000	7,220,303





Ndërkohë për vitin 2007, për herë të parë, APAAL ka bërë një analizë të thelluar të financave dhe përdorimit të tyre të cilat jepen më poshtë. Në këto të dhëna paraqiten të dhënat lidhur me buxhetin total të APAAL për vitin 2007, shpërndarja sipas zërave kryesorë financiarë, përdorimi i shpenzimeve operative dhe raporti midis shpenzimeve operative që lidhen direkt me aktivitetet specifike të APAAL në raport me shpenzimet e përgjithsme operative, si indikator i eficiencës dhe efektivitetit të përdorimit të financave.

Përdorimi i burimeve njerëzore e financiare për vitin 2007

Buxheti i APAAL për vitin 2007 sipas zërave kryesorë financiarë; buxheti sipas nënzërave të 602; zërat kryesorë të lidhur me aktivitetet kryesore në raport me shpenzimet operative





Kjo skemë do të përdoret në fund të çdo viti financiar si tregues vlerësimi aftësinë menaxhuese, efektivitetin dhe mirëpërdorimin e burimeve financiare. Kjo analizë bëhet pjesë e Raportit Vjetor të APAAL dhe KA që bëhet publik në fillim të çdo viti pasardhës. Në web site e APAAL ndodhet ky raport për vitin 2007.

9. Mbështetja e veprimtarisë së Këshillit të Akreditimit

Një nga detyrat e Agjencisë është dhe mbështetja që ajo i jep Këshillit të Akreditimit me Sekretarin Teknik, infrastrukturën, logjistikën dhe mbështetjen shkresore e komunikuese me MASH e IAL.. Agjencia organizon mbledhjet e Këshillit, përgatiti axhendën e takimeve, programin e mbledhjeve, përgatit dhe shpërndan informacionin antarëve të këshillit dhe përgatit dokumentin përfundimtar të Këshillit përpara se ai të shqyrtohet e miratohet. Agjencia mbulon gjithashtu të gjithë korrespondencën me institucionet e tjera në emër të këshillit.

Gjatë periudhës tre vjeçare gusht 2005-gusht 2008, APAAL ka mbështetur organizimin dhe përgatitjen e dokumentacionit të rreth 45 mbledhjeve të KA dhe ka hartuar e dërguar në MASH një sërë dokumentash e rekomandimesh në emër dhe për KA.

I gjithë aktiviteti dhe dokumentacioni i KA organizohet dhe ruhet në një arkivë të veçantë të APAAL nga Sekretari Teknik i KA që, sipas strukturës së re të APAAL, është specialist pranë APAAL.

DREJTORE

DHURATA BOZO